BANKA E SHQIPËRISË

Revista Ekonomike

6M1-2023

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

** Pikëpamjet e shprehura në këto artikuj janë të autorëve, punonjës të Bankës së Shqipërisë, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucionit.*

P Ë R M B A J T J A

ANALIZË E ECURISË SË ÇMIMEVE PËR METËR KATROR TË QIRAVE NË TIRANË, DHE ZONAT BREGDETARE E QENDRORE TË VENDIT GJATË PERIUDHËS 2017-2022 *5*

Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË WORKSHOPIN XVII TË KËRKIMEVE EKONOMIKE TË EVROPËS JUGLINDORE *13*

ANALIZË E ECURISË SË ÇMIMEVE PËR METËR KATROR TË QIRAVE NË TIRANË, DHE ZONAT BREGDETARE E QENDRORE TË VENDIT GJATË PERIUDHËS 2017-2022

Orion Garo, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

HYRJE DHE PARASHTRIM KONTEKSTI

Çmimet e qirave janë një element i rëndësishëm i dinamikave të tregut të pasurive të paluatjshme. Ato kanë një lidhje të ndërsjellë dhe të pandashme me çmimet e banesave, pasi ecuritë e tyre influencohen nga të njëjtët shtytës ekonomikë, ndër të cilët më i rëndësishmi është kërkesa për strehim. Qiratë janë një mënyrë e përshtatshme e shfrytëzimit të pronës nga jopronarët, të cilët nuk janë të interesuar ose nuk kanë mundësi financiare të zotërojnë një banesë të tyren.

Qiramarrësit përfaqësojnë atë kategori të kërkesës konsumatore që përcakton vlerën reale të strehimit pasi, nëse blerja e një banese konsiderohet njëkohësisht plotësim i nevojave të strehimit dhe investim afatgjatë në një aktiv fizik, qiramarrja thjesht plotëson nevojat aktuale për strehim. Njëkohësisht, banesat e dhëna me qira janë aktive fizike që u mundësojnë pronarëve të ardhura periodike dhe relativisht të qëndrueshme. Në ndryshim nga pagesat e blerjes së banesës, të cilat tipikisht bëhen vetëm një herë në momentin e transferimit të pronësisë nga shitësi tek blerësi, pagesat e qirave bëhen në mënyrë periodike nga qiramarrësi tek qiradhënësi.

Në kushtet e një tendence të rritjes së përgjithshme të çmimeve tek pasuritë e paluajtshme, ky material kërkimor ka për qëllim analizimin e ecurisë së çmimeve të qiradhënies së banesave në Tiranë dhe në zonat e tjera të vendit, bazuar në të dhënat e siguruara nga interneti nëpërmjet metodave "web scrapping" dhe mjeteve zbatuese "big data". Më konkretisht, objektivi është identifikimi i niveleve mesatare të qirave për metër katror të banesave, dhe vrojtimi i ecurive të tyre gjatë periudhës kohore të shqyrtuar, për tri ndarje gjeografike: Tiranën, zonat bregdetare dhe zonat qendrore të vendit.

Të dhënat janë marrë nga platforma web "njoftime.com" (2023), e cila disponon një historik të dhënash për të gjithë territorin e vendit, që nga viti 2017. Si në rastin e Garo (2022), mjetet zbatuese dhe procedurat e grumbullimit elektronik të të dhënave përfshijnë platformën dhe gjuhën programuese Python së bashku me nënkomponentin e saj Scrapy, ndërsa mjetet zbatuese dhe procedurat e përpunimit dhe organizimit të të dhënave përfshijnë gjuhën programuese M, programin MS Excel dhe funksionalitetet ndihmëse të tij Power Query dhe Power Pivot. Në total kemi marrë në analizë mbi 34 mijë vrojtime të çmimeve të listuara online të pronave të ofruara për qiradhënie, kryesisht në Tiranë[1] dhe në zonat e tjera. Nga përpunimi i informacionit kemi nxjerrë një seri me

[1] *Rreth 95% e listimeve për qiradhënie janë për Tiranën.*

frekuencë mujore të mesatareve të çmimeve të qirave për metër katror, në kryeqytet dhe në territoret bregdetare e qendrore të vendit.

Analiza jonë tregon se gjatë dy viteve të fundit vërejmë një tendencë rritëse të qirave në linjë me rritjen e çmimeve të apartamenteve, pohuar nga Garo (2022) përkatësisht me 13.4% në vit në Tiranë, 24.1% në vit në zonat bregdetare, dhe 17.3% në vit në zonat qendrore të vendit. Pjesa në vazhdim e materialit bën një përshkrim të të dhënave dhe metodologjisë së përdorur, paraqet detaje lidhur me rezultatet e analizës, dhe në fund ofron disa konkluzione mbi rezultatet e marra.

TË DHËNAT DHE METODOLOGJIA

Kampioni përbëhet nga 34,053 vrojtime (listime të çmimeve të banesave të ofruara për qiradhënie), të cilat shtrihen në një hark kohor prej 6 vitesh, nga janari 2017 deri në dhjetor 2022. Të dhënat janë ndarë në tri grupe: [1] kryeqytet, për të gjitha listimet e banesave të ofruara për qira brenda një rrezeje prej 5 km nga qendra e Tiranës; [2] bregdet, për të gjitha listimet në qytetet, qytezat dhe zonat rurale bregdetare të vendit, dhe; [3] qendrore, për të gjitha listimet në qytetet, qytezat dhe zonat rurale në territoret qendrore të vendit[2]. Kjo ndarje i referohet asaj të përdorur në analizën e bërë nga Banka e Shqipërisë mbi "Tregun e pasurive të paluajtshme në Shqipëri", në Raportin e Stabilitetit Financiar (2021). Specifikat e përfshirjes së vrojtimeve në kampion, janë të njëjta me ato të paraqitura në Garo (2022).

Në mënyrë të përmbledhur, mund të themi që kampioni përmban listimet për qira në pallate, si dhe ambiente të shtëpive e vilave një deri në pesë kate në zonat rurale e urbane të vendit, por përjashton listimet për qira të ndërtesave e objekteve: [i] ku ushtrohen aktivitete që s'kanë lidhje me strehimin, dhe [ii] që jepen me qira së bashku me sipërfaqe të konsiderueshme toke apo burime natyrore. Krahas tyre, një specifikë e shtuar është ajo e periodicitetit të pagesës së qirasë: kështu nëse kërkesa e pagesës së qirasë është mbi një bazë ditore ose javore, vrojtimet me këtë veçanti jane përjashtuar nga kampioni.

Proporcionaliteti i vrojtimeve të kampionit është i tillë ku 95.2% e listimeve i përkasin qiradhënieve të banesave në Tiranë, 2.2% i përkasin qiradhënieve në bregdet, dhe 2.6% e listimeve i përkasin qiradhënieve në zonat qendrore të vendit. Gjithsej kanë rezultuar mesatarisht 473 vrojtime për çdo muaj. Frekuenca kohore e analizës është përcaktuar të jetë mujore. Grafiku 1 paraqet shpërndarjen në kohë të vrojtimeve sipas zonave gjeografike.

[2] *Shih Garo (2022) për arsyet e përcaktimit të një rrezeje distance për kryeqytetin, dhe për qarqet e vendit që klasifikohen në zonat bregdetare dhe ato qendrore.*

Grafik 1. Disponueshmëria e vrojtimeve sipas zonave gjeografike



Burimi: Llogaritje të autorit me të dhënat e siguruara nga platforma "njoftime.com".

Pastrimi dhe organizimi në formë tabelare i të dhënave u realizua duke përcaktuar variablat si dhe duke eliminuar vrojtimet me vlera të skajshme periferike dhe ato me vlera të munguara. Variablat si: qyteti/fshati, zona gjeografike përkatëse, sipërfaqja në metra katrorë, dhe çmimi i qirasë në Lekë ose Euro në muaj, u përcaktuan duke identifikuar pjesëzat e nevojshme të informacionit nga ai bruto nëpërmjet komponentit Power Query të MS Excel. Për çdo vrojtim u llogarit çmimi për metër katror në Lekë dhe në Euro duke iu referuar kursit të këmbimit në periudhën përkatëse.

Në lidhje me kontekstin ekonometrik të analizës, vlen të sqarohet se seritë e vlerave të vrojtuara të mesatareve mujore të çmimeve për metër katror të qirave (grafiku 2) shfaqin luhatje të ndjeshme. Kjo vihet re më së shumti tek seritë për bregdetin dhe zonat qendrore, për arsye se vrojtimet që i përkasin këtyre serive janë më të pakëta në numër se vrojtimet e serisë së kryeqytetit. Në këto kushte, për të shqyrtuar qartë diferencat në çmime midis kryeqytetit, bregdetit, dhe zonave qendrore është më me dobi të merren në analizë trendet e mesatareve mujore të çmimeve dhe jo vetë vlerat mesatare.

Një nga zbatimet më të njohura të kësaj teknike është algoritmi i filtrit Kalman, i cili është një proces përsëritës llogaritjeje në kuadrin e modelit të elementeve të pavrojtuara, brenda kornizës së gjerë të modelimit regresiv "state space" (SAS Institute, 2017). Cilësia thelbësore e këtij algoritmi është zbërthimi i elementeve të pavrojtuara të serisë – të cilat janë trendi, sezonaliteti, ciklikaliteti, elementi autoregresiv dhe gabimi – me qëllim analizimet e veçanta të tipareve të tyre (Pelagatti, 2016). Në këtë kontekst, synimi ynë është të veçojmë elementin e trendit të secilës prej tri serive, për të shqyrtuar për secilën seri, tiparet e ecurisë së tij dhe për të identifikuar më lehtësisht diferencat në vlerë midis serive. Specifikimi i modelit të elementeve të pavrojtuara, për nevojat specifike të kërkimit tonë, është i formës:

$$y_t = \mu_t + \gamma_t + \varepsilon_t,$$

ku:

i. μ_t është elementi i trendit, i cili ka një zbërthim të vetin në dy komponentë, nivel β_t dhe pjerrësi σ_t, ku:

$$\mu_t = \beta_{t-1} + \sigma_{t-1} + \eta_t, \qquad ku: \eta_t \, NIID(0,\sigma_\eta^2), \qquad (niveli);$$

$$\sigma_t = \sigma_{t-1} + \xi_t, \qquad ku: \xi_t \, NIID(0,\sigma_\xi^2), \qquad (pjerrësia);$$

ii. y_t është elementi i sezonalitetit;
iii. ε_t është gabimi i specifikimit, me trajtën e një zhurme të bardhë $NIID$.

REZULTATET

Grafiku 2 ofron një diagramë të vrojtimeve të të gjithë kampionit, përfshirë dhe ato të zonave bregdetare e qendrore të vendit. Në të, vija e kuqe përfaqëson trendin e mesatareve mujore të çmimeve për metër katror të qirave në lekë për kryeqytetin, vija blu përfaqëson bregdetin, ndërsa vija e gjelbër zonat qendrore. Siç është prezantuar edhe tek metodologjia, tre trendet janë llogaritur nëpërmjet procedurës "PROC UMC" të SAS, bazuar në algoritmin Kalman. Këto trende i kemi llogaritur si shumë vetëm e nivelit dhe pjerrësisë së regresit, dhe janë të zhveshura nga sezonaliteti dhe gabimi i serive të modeluara.

Këtu duhet vënë në dukje që elementi i sezonalitetit rezultonte i pranishëm në të trija seritë, dhe statistikisht i rëndësishëm në dy nga tri seri. Duhet cilësuar gjithashtu që elementet e ciklikalitetit dhe autoregresit janë lënë jashtë modelit, pasi në bazë të kritereve AIC dhe BIC nuk ofronin vlerë të shtuar për asnjërin prej tri modeleve.

Të dhënat shfaqin disa tendenca interesante në lidhje me çmimin e qirave në Tiranë dhe në territoret e tjera. Kështu në fillim të vitit 2017, mesatarja e qirasë mujore për metër katror ka nisur me 475 lekë për Tiranën, dhe 260 lekë e 310 lekë përkatësisht për bregdetin dhe për zonat qendrore. Pra, hendeku fillestar midis kryeqytetit dhe pjesës tjetër të vendit rezulton të jetë rreth 190 lekë. Ky nivel për gjithë vendin rezulton sa 60% e çmimeve të kryeqytetit.

Në vijimësi vërejmë se çmimet e qirave në Tiranë kanë shfaqur rritje graduale të vazhdueshme, që deri në vitin 2020 rezultojnë të jenë rritur me 12% krahasuar me fillimin e serisë. Ndërkohë çmimet për bregdetin kanë shfaqur një trend me luhatje, fillimisht me tendencë rritëse, por që ka pësuar rënie gjatë vitit 2019, dhe që në vitin 2020 rezultojnë me një rritje me rreth 5% krahasuar me fillimin e serisë. Këtu spikasin çmimet e zonave qendrore të vendit, të cilat kanë shfaqur trend rënës përgjatë periudhës së lartpërmendur, dhe në vitin 2020 rezultojnë të jenë pak a shumë në të njëjtin nivel me fillimin e serisë.

Grafik 2.Ecuria e çmimeve për m² të qirave të banesave sipas të gjitha zonave gjeografike



Burimi: Llogaritje të autorit me të dhënat e siguruara nga platforma "njoftime.com"

Pavarësisht diferencës midis nivelit të qirave të kryeqytetit dhe pjesës tjetër të vendit, pas vitit 2020 vërehet një trend rritës për të gjitha seritë. Gjithnjë referuar Grafikut 2, nëse fokusohemi tek 2021 dhe 2022 – dy vitet e fundit të periudhës kohore për të cilën disponojmë të dhëna – rritja mesatare mujore e çmimeve të qirave rezultoi: për Tiranën 1.02%, për bregdetin 1.8%, dhe për zonat qendrore 1.3%. Këto shifra tregojnë për një përshpejtim të dukshëm të rritjes së çmimeve të qirave në bregdet, krahasuar me kryeqytetin dhe territorin qendror të vendit.

Duke e përqendruar vëmendjen gjithnjë tek çmimi për metër katror i qirasë mujore, që në Tiranë – në dhjetor 2022 – ishte 675 lekë, hendeqet aktuale rezultojnë të jenë: rreth 200 lekë midis Tiranës dhe bregdetit, dhe rreth 225 lekë midis Tiranës dhe zonave qendrore. Referuar çmimeve të lartpërmendura për dhjetorin, qiraja mesatare e një apartamenti tipik banimi 85 metra katrorë, me dy dhoma gjumi, një dhomë ndenjeje, një kënd gatimi, një banjo e një ballkon: në Tiranë rezulton 57,375 lekë, në bregdet 40,375 lekë, dhe në zonat qendrore të vendit 38,250 leke. Referuar nivelit të çmimeve të Tiranës, në terma përqindjeje, çmimet në bregdet janë sa 70.3% e këtij niveli, ndërsa çmimet e zonave qendrore janë sa 66.7% e tij.

Për më tepër, Grafiku 2 na ndihmon të kuptojmë më qartë reagimet e tregut të qirave në zonat bregdetare dhe ato qendrore, gjatë periudhës së fatkeqësive natyrore në gjashtëmujorin e dytë 2019, dhe gjatë izolimit ekonomik për shkak të COVID-19, në tremujorin e dytë 2020. Siç vërehet, në këto dy periudha çmimet ulen dukshëm nën nivelet e trendeve përkatëse, çka na lë të kuptojmë se fatkeqësitë natyrore dhe izolimi ekonomik ushtruan impakt negativ tek çmimet e qirave në bregdet dhe zonat qendrore të vendit.

Ndërkohë, siç e kemi cilësuar, ky impakt rezultoi thuajse i papërfillshëm tek çmimet e qirave në Tiranë. Për vitin 2022, niveli mesatar i çmimeve për metër katror të qirasë mujore në Tiranë ishte 653 lekë, në bregdet ishte 435 lekë, ndërsa në zonat qendrore ishte 416 lekë. Krahasuar me vitin 2021, rritja vjetore e çmimeve të qirave rezultoi: për Tiranën 13.4%, për bregdetin 24.1%, ndërsa për zonat qendrore 17.3%.

Duke qenë se pjesa më e madhe e vrojtimeve është për Tiranën, vëmendje të shtuar i kemi kushtuar analizës së ecurisë në këtë zonë. Kështu, grafiku 3 paraqet shpërndarjen në kohë të mesatareve të çmimeve mujore të qirave për metër katror në Tiranë, në Lekë dhe në Euro. Duke qenë se kemi të bëjmë me të njëjtat vrojtime, ecuria e çmimeve për këto dy monedha është praktikisht e njëjtë; mospërputhjet e pjesshme reflektojnë luhatjet në kursin e këmbimit.

Grafik 3. Ecuria e çmimeve për m² të qirave të banesave në Tiranë



Burimi: Burimi: Llogaritje të autorit me të dhënat e siguruara nga platforma "njoftime.com".

Ndërsa në grafikun 4 kemi paraqitur ndryshimet vjetore dhe mujore të çmimeve të banesave të Tiranës. Vërejmë që gjatë periudhës së fatkeqësive natyrore në gjashtëmujorin e dytë 2019, çmimet e qirave në kryeqytet mbeten relativisht të pandikuara; pasojat ekonomike nga tërmetet duket se nuk e cënuan trendin e tyre. Pothuaj e njëjta gjë konstatohet edhe në periudhën e izolimit ekonomik për shkak të COVID-19, në tremujorin e dytë 2020; vërehet një ulje e lehtë e trendit të çmimeve por jo ndonjë ndryshim ekstrem.

Grafik 4. Normat e rritjes së çmimeve në lekë për m² të qirave të banesave në Tiranë (vjetore dhe mujore)



Burimi: Burimi: Llogaritje të autorit me të dhënat e siguruara nga platforma "njoftime.com".

Menjëherë pas periudhës së izolimit për shkak të COVID-19, qiratë marrin një trend të ndjeshëm rritës, i cili vijon për rreth 1.5 vite, deri në janar të vitit 2022. Marsi i 2022 shënoi dhe fillimin e presioneve inflacioniste në çdo fushë të ekonomisë vendase, të nxitura kryesisht nga pamjaftueshmëria e ofertës së naftës dhe nënprodukteve të saj në Eurozonë, si pasojë e fillimit të konfliktit ndërkombëtar dhe sanksioneve ekonomike që pasuan. Tregu i qirave të kryeqytetit gjatë kësaj periudhe reagon me një thyerje të trendit të fortë rritës të çmimeve, ku vijueshmëria e trendit (deri në fund të disponueshmërisë së të dhënave) edhe pse mbetet rritëse, nuk karakterizohet nga rritje e vrullshme, por nga luhatje të shpeshta.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE

Ky projekt kërkimor ofron plotësim informacioni mbi dinamikat e tregut të pasurive të paluajtshme në vendin tonë, duke marrë në analizë çmimet për metër katror të qirave në Tiranë dhe zonat bregdetare e qendrore të vendit gjatë 6 viteve të fundit. Sikurse në rastin e kërkimit pararendës mbi çmimet e banesave (Garo, 2022), edhe ky studim u krye duke përdorur të dhëna mikro të mbledhura elektronikisht nëpërmjet nëpërmjet metodave "web scrapping" dhe mjeteve zbatuese "big data".

Llogaritja e niveleve mesatare të çmimeve të qirave në Tiranë, bregdet dhe zonat qendrore të vendit, si dhe vëzhgimi i dinamikave të tyre në kohë konsistojnë në objektivin e këtij kërkimi. Platforma web njoftime.com ishte burimi i të dhënave për rreth 34,000 mijë vrojtime (listime për qiradhënie), gjatë harkut kohor janar 2017 - dhjetor 2023.

Fillimisht u mblodhën të dhënat bruto nëpërmjet Python dhe nën-komponentit të tij Scrapy, pastaj u organizuan në trajtën e informacionit tabelar, duke përcaktuar variablat, duke shmangur vrojtimet e panevojshme, vlerat e skajshme periferike dhe ato të munguara. Së fundi, u morën në analizë trendet e mesatareve mujore të çmimeve, të cilat u siguruan nëpërmjet teknikës ekonometrike Kalman, pjesë e procedurës së elementeve të pavrojtuara në programin SAS. Më poshtë renditen gjetjet kryesore të kërkimit:

- Pas ndarjes së të dhënave në bazë të vendndodhjes gjeografike, duke iu referuar mesatares aktuale të qirasë mujore për metër katror në Tiranë, e cila vlerësohet 675 lekë:
    - hendeku midis Tiranës dhe zonave bregdetare rezulton rreth 200 lekë, pra niveli i çmimeve të qirave në bregdet rezulton rreth 70.4% i atij në Tiranë;
    - hendeku midis Tiranës dhe zonave qendrore të vendit është rreth 225 lekë, rrjedhimisht niveli i çmimeve të qirave në zonat qendrore është rreth 66.7% i atij në Tiranë;
    - hendekun midis bregdetit dhe zonave qendrore mund ta evidentojmë si të papërfillshëm.
- Pas analizimit të trendeve përkatëse, vërehet se:
    - Qiratë në Tiranë, prej fillimit të serisë, shfaqin një trend gradual rritës deri në vitin 2020. Gjatë këtij viti trendi shfaq një farë stacionariteti, dhe me fillimin e vitit 2021 e në vijim, ai përshpejtohet dukshëm.

Gjatë dy viteve të fundit të periudhës kohore të shqyrtuar, qiratë e kryeqytetit janë rritur mesatarisht me 1.02% në muaj.

- Seria për zonat bregdetare fillon me nivelin më të ulët të qirave në vend, dhe deri në vitin 2020 vijon me një luhatje që kulmon në mesin e vitit 2018, dhe në fundin e 2019-ës (pikërisht kur ekonomia vendase goditet nga fatkeqësitë natyrore) bie sërish në nivelin e fillimit të serisë. Si në rastin e kryeqytetit, gjatë dy viteve të fundit trendi i qirave në bregdet përshpejtohet dukshëm, veçanërisht gjatë vitit 2022. Gjatë kësaj periudhe, qiratë në bregdet janë rritur mesatarisht me 1.8% në muaj.
- Qiratë në zonat qendrore të vendit vërehen të jenë relativisht stacionare, me një trend të lehtë rënës deri në fundin e vitit 2019. Ato ulen dukshëm nën nivelin e trendit gjatë izolimit ekonomik për shkak të COVID-19, çka tregon se tregu i qirave pësoi goditje në të gjithë vendin, me përjashtim të kryeqytetit. Hapja e ekonomisë pas periudhës së izolimit shënon fillimin e përshpejtimit të trendit të qirave për këtë ndarje gjeografike, e cila gjatë dy viteve të fundit paraqet një rritje mesatare mujore prej 1.3%.

- Tregu i qirave të kryeqytetit shfaq një reagim të dukshëm kundrejt presioneve inflacioniste që përfshinë Evropën dhe vendin tonë duke filluar nga tremujori i dytë 2022, pasi ka një thyerje të qartë të vijueshmërisë rritëse të trendit dhe luhatje të shpeshta të tij gjatë këtij segmenti kohor.

REFERENCA

Banka e Shqipërisë. (2021). Rezultatet e vrojtimit "Tregu i pasurive të paluajtshme" dhe indeksi i cmimeve të banesave. Departamenti i Stabilitetit Financiar, Tiranë.

Garo, O. (2022). Real time obtained real estate prices: the web scrapping methogology. Tirana: Bank of Albania.

Pelagatti, M. M. (2016). Time Series Modelling with Unobserved Components. Boca Raton, FL, USA: CRC Press.

SAS Institute. (2017). The UCM Procedure. Në SAS/ETS® 14.3 User's Guide (fv. 2861-2981). Cary NC: SAS Institute Inc.

Shoqata "Miqësia". (2023, Janar 21). Shtëpi me qira. Gjetur në Njoftime.com: 2023

THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË WORKSHOPIN XVII TË KËRKIMEVE EKONOMIKE TË EVROPËS JUGLINDORE

Në datat 4 dhe 5 dhjetor 2023, Banka e Shqipërisë do të organizojë në Tiranë Workshop-it XVII të Kërkimeve Ekonomike të Evropës Juglindore. Ky workshop synon të ofrojë një forum diskutimi të punëve kërkimore mbi çështje të lidhura me bankën qendrore dhe të nxisë shkëmbimin e pikëpamjeve midis kërkuesve të Bankës së Shqipërisë, të bankave qendrore të rajonit e më gjerë, si edhe të institucioneve financiare e akademike vendase dhe të huaja.

Autorët e interesuar janë të ftuar të marrin pjesë me punimet e tyre kërkimore, duke dorëzuar një abstrakt të zgjeruar ose studimin e plotë, brenda datës 2 tetor 2023, në adresën: BoAresearchworkshop@bankofalbania.org. Për detaje të mëtejshme referojuni më poshtë: "Thirrjes për aplikime në workshop-in XVII të Kërkimeve Ekonomike të Evropës Juglindore" (në anglisht).

https://www.bankofalbania.org/Shtypi/Njoftimet_per_shtyp/Thirrje_per_aplikime_Workshop-i_XVII_i_Kerkimeve_Ekonomike_te_Evropes_Juglindore_Tirane_4-5_dhjetor_2023.html